

“UNIFIN” Shoqëri Kursim Krediti

Pasqyrat financiare

Me dhe për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2019

PËRMBAJTJA

FAQE

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

PASQYRAT FINANCIARE:

Pasqyra e pozicionit financiar	5
Pasqyra e te ardhurave gjithëpërfshirëse	6
Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto	7
Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare	8
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare	9–34

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për Anëtarët e Unifin Shoqëri Kursim Krediti,

Opinionit i kualifikuar

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Unifin Shoqëri Kursim Krediti (më poshtë “Shoqëria” ose “Unifin SHKK”) që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2019, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare për periudhën e mbyllur në këtë datë, si edhe një përmbledhje të politikave kontabël dhe shënimeve të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të çështjeve të përmendura në *bazat për opinionin e kualifikuar*, pasqyrat financiare të Unifin SHKK paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2019, performancën e saj financiare dhe flukset e mjeteve monetare për periudhën e mbyllur dhe ndryshimet në kapital në atë datë, në përputhje me Standardet Nderkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Bazat për Opinionin e kualifikuar

Sic shprehet në shënimin 3.11 të pasqyrave financiare, të ardhurat nga interesi i kredive njihen atëherë kur arkëtohen dhe jo në bazë rritëse atëherë kur përfitohen. Kjo nuk është në përputhje me standartet ndërkombëtare të raportimit financiar sipas të cilave të ardhurat duhet të njihen në momentin e përfitimit. Ne nuk ishim në gjendje të vlerësonim sa do të ishte efekti i saktë i përllogaritjes së të ardhurave në bazat rritëse, në të ardhurat dhe aktivet e Shoqërisë.

Sic shprehet në shënimin 3.6 të pasqyrave financiare, provizionet për rënien në vlerë të kredive llogariten bazuar vendimit Nr. 105 të bankës së Shqipërisë për miratimin e rregullores “Për administrimin e riskut në veprimtarinë e Shoqërive të kursim kreditit dhe unioneve të tyre” të aprovuara nga Këshilli i Mbikqyrjes më 5 Tetor 2016. Shoqëria nuk ka bërë një përllogaritje të provizionit bazuar në SNRF 9 “Instrumentet Financiare”. Ne nuk ishim në gjendje të vlerësonim sa do të ishte efekti i saktë i përllogaritjes së provizionit bazuar në SNRF 9, dhe si rezultat sa do të ishte efekti i saj në të ardhurat dhe aktivet e Shoqërisë.

Sic shprehet në shënimin 3.9 të pasqyrave financiare totali i pagesave të kryera për qiratë njihet si shpenzim operativ në pasqyrën e pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse. Shoqëria nuk ka aplikuar SNRF 16 “Qiratë”. Ky standard kërkon që qeratë të kontabilizohen sipas modelit “të së drejtës së perdorimit”. Qiratë të cilat transferojnë tek shoqëria në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet që shoqërojnë pronësinë e aktivit të marrë me qira, kapitalizohen në momentin e fillimit të qirasë me vlerën e drejtë duke njohur njëkohësisht për të njëjën vlerë një detyrim qeraje. Nje aktiv i marre me qira mund të amortizohet përgjatë periudhës më të shkurtër midis jetës së dobishme dhe kohëzgjatjes së qirasë. Pagesat e qirase zvogëlojnë detyrimin e qirasë dhe mbulojnë interesin financiar. Interesat financiare njihen si kosto financiare në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse. Pagesat për qira afatshkurtra më pak se 12 muaj njihen si shpenzime operative në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në bazë lineare gjatë afatit të qirasë. Në mënyrë të ngjashme trajtohen edhe qiratë e aseteve me vlerë të ulët prej 5,000 Euro ose më pak. Ne nuk ishim në gjendje të vlerësonim sa do të ishte efekti i përllogaritjes së aktivit me të drejtë përdorimi dhe detyrimeve të lidhura me qiratë më 31 dhjetor 2019, dhe si rezultat sa do të ishte impakti aktivet dhe detyrimet e Shoqërisë.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit Ndërkombëtar për Standardet e Etikës për Kontabilistët (Kodi i IESBA) dhe Kodit të Instituit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (Kodi i IEKA), së bashku me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 Mars 2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të amenduar, që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë të modifikuar.

Ngjarja e mashtrimit

Ne tërheqim vëmendje në shënimin 21 të pasqyrave financiare të Shoqërisë në lidhje me një ngjarje mashtrimi që ka ndodhur nga një punonjëse e Shoqërisë. Mashtrimi përfshinte krijimin e kredive fiktive duke përvetësuar shumat e disbursuara dhe tërheqje të pa-autorizuara të depozitave dhe llogarive rrjedhëse nëpërmjet falsifikimit të firmave.

Nga vetëdeklarimet e punonjësës dhe verifikimet e mëtejshme të kryera nga Shoqëria rezultoi se humbja totale nga mashtrimi deri më 31 Mars 2019 ishte 120,900,241 Lekë (31 Dhjetor 2018 ishte 116.398.580).

Opinionin yne nuk modifikohet në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen Për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me ligjin shqiptar “Mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe rregulloren e Bankës së Shqipërisë “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e shoqërive të kursim kreditit dhe të unioneve të tyre”, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, për shënimet shpjeguese për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveç sa më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësia e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

TPA Albania shpk

Rr.Reshit Collaku, Pall.Shallvare, Apt.44, 1000 Tirana, Albania


www.tpa-group.com

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së entitetit për vijësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar me qeverisjen, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Datë 15 Tetor 2020


Ilir Binaj CPA, CGMA, Auditor i Lirë



TPA Albania shpk

Rr.Reshit Collaku, Pall.Shallvare, Apt.44, 1000 Tirana, Albania

www.tpa-group.com

“UNIFIN” Shoqëri Kursim Krediti**31 Dhjetor 2019****Pasqyra e pozicionit financiar***(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)*

	Shënime	31 Dhjetor 2019	31 Djeter 2018
Aktivët			
Mjetet monetare	6	331,033,996	203,542,258
Bono thesari	7	-	24,822,897
Kredi të dhëna anëtarëve (neto)	8	806,681,837	872,872,048
Aktive afatgjata materiale	9	13,372,450	14,985,956
Aktive afatgjata jo materiale	10	1,174,901	1,325,514
Aktive te tjera	11	1,198,131	1,465,321
Totali i aktiveve		1,153,461,315	1,119,013,994
Detyrimet			
Depozita nga anëtarët	12	1,020,485,854	991,439,233
Detyrime të tjera	13	5,024,520	17,543,650
		1,025,510,374	1,008,982,883
Kapitali			
Kontribute te anetaresimit dhe donacione	14	85,322,665	82,461,615
Rezerva		47,040,561	34,760,984
Teprica/(deficit) i mbartur		(4,412,285)	(7,191,488)
Totali i kapitalit		127,950,941	110,031,111
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		1,153,461,315	1,119,013,994

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet 1 deri në 34, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Unifin SHKK për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 u aprovuan nga Drejtimi i SHKK më 16 Tetor 2020 dhe janë firmosur nga:

Elvana Sharkaj

Administratore



Aulona Tefa

Drejtoreshë finance

“UNIFIN” Shoqëri Kursim Krediti
31 Dhjetor 2019
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

	Shënime	31 Dhjetor 2019	31 Djetor 2018
Te ardhura nga interesi	15	118,289,552	120,940,725
Shpenzime interesi	16	(33,746,141)	(29,984,380)
Te ardhura neto nga interesi		84,543,411	90,956,345
Shpenzimet e provizionit		(44,706,309)	(9,759,175)
Te ardhura neto pas zhvleresimit te huave		39,837,102	81,197,170
Te ardhura nga kthim i kredive te fshira		5,478,152	4,056,561
Te ardhura te tjera	17	30,992,741	1,878,324
Te ardhura te tjera		36,470,893	5,934,885
Shpenzime personeli	18	(45,186,930)	(50,398,336)
Shpenzime administrative	19	(22,087,164)	(25,317,540)
Zhvleresimi dhe amortizimi	9,10	(2,073,266)	(1,960,945)
Humbja nga mashtrimi	20	(4,314,461)	(116,398,580)
Fitim /(Humbje) neto nga kembimi valutator		133,029	178,942
Totali i shpenzimeve operative		(73,528,792)	(193,896,459)
Fitimi/(humbja) neto i vitit		2,779,203	(106,764,404)
Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Rezultati i vitit		2,779,203	(106,764,404)

Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet 1 deri në 34, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

“UNIFIN” Shoqëri Kursim Krediti**31 Dhjetor 2019****Pasqyra e ndryshimeve në kapital***(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)*

	Kontribute të anëtarësimit dhe Donacione	Rezervat	Teprica/(Deficiti) i mbartur	Totali
<i>Gjendja më 1 janar 2018</i>	85,238,871	34,760,984	99,572,916	219,572,771
Rritje/(reduktim) i kapitalit	(2,777,256)	-	(106,764,404)	(109,541,660)
Rezultati i vitit	-	-	-	-
<i>Gjendja më 31 dhjetor 2018</i>	82,461,615	34,760,984	(7,191,488)	110,031,111
Rritje/(reduktim) i kapitalit	2,861,050	12,279,577	2,779,203	17,919,830
Rezultati i vitit	-	-	-	-
<i>Gjendja më 31 dhjetor 2019</i>	85,322,665	47,040,561	(4,412,285)	127,950,941

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet 1 deri në 34, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

“UNIFIN” Shoqëri Kursim Kredi
31 Dhjetor 2019
Pasqyra e flukseve monetare
(Të gjitha shumat janë në LEK)

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
<i>Flukse monetare nga aktiviteti operacional</i>		
Rezultati i vitit	2,779,203	(106,764,404)
<i>Rregullime për rakordimin e rezultatit neto me aktivitetet e shfrytëzimit:</i>		
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	2,073,266	1,960,945
Humbja nga nxjerrja jashte perdorimi e aktiveve	-	207,689
Shpenzimi i privizionit	44,706,309	9,759,175
Të ardhura nga interesi	(118,289,552)	(120,940,725)
Shpenzime interesi	33,746,141	29,984,380
Fluksi neto nga aktiviteti i shfrytëzimit para ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operacionale	(34,984,633)	(185,792,940)
<i>Ndryshimet e aktiveve dhe detyrimeve të shfrytëzimit:</i>		
(Rritje)/ rënie në tëpricën e aktiveve të tjera	267,190	6,504,871
(Rritje)/ rënie e kredisë	21,483,902	(168,580,812)
Rritje/ (rënie) e depozitave të anëtarëve	24,281,695	174,578,435
Rritje/ (rënie) e detyrimeve të tjera	(12,519,130)	(5,678,819)
Flukset neto nga aktiviteti operacional	(1,470,976)	(178,969,265)
Interesi i arkëtuar	118,289,552	120,940,725
Interesi i paguar	(28,981,215)	(29,462,942)
	87,837,361	(87,491,482)
Flukset e parasë nga aktivitetet investuese		
Investime në bono thesari	-	(24,445,594)
Bono thesari te maturuara	24,822,897	40,000,000
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	(309,147)	(2,689,378)
Flukset monetare neto nga aktivitetet investuese	24,513,750	12,865,028
<i>Flukse monetare nga veprimtaritë financuese:</i>		
Rritje/ (rënie) e kapitalit	2,861,050	(2,777,256)
Rritje e rezervave	12,279,577	-
Fluksi monetar neto i përdorur në veprimtaritë financuese	15,140,627	(2,777,256)
(Rënie)/ rritje neto e mjeteve monetare	127,491,738	(77,403,710)
Mjete monetare në fillim të periudhës	203,542,258	280,945,968
Mjete monetare në fund të periudhës	331,033,996	203,542,258

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet 1 deri në 34, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Unifin Shoqëri Kursim Krediti (“Unifin SHKK” ose “Organizata”) është një Shoqëri Kursim Krediti e cila zhvillon veprimtarinë e saj në bazë të ligjit Nr. 52 “Për shoqëritë e kursim kreditit dhe unionet e tyre”. Unifin SHKK është krijuar si rezultat i bashkimit me përthithje të Unionit të Shoqërive të Kursim Kreditit “Jehona” dhe Shoqërise së Kursim Kreditit “NewCred”.

Në 3 Dhjetor 2016 u mbajt Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë së Kursim Kreditit “NewCred” dhe Asambleja e Përgjithshme e Unionit të SHKK-ve “Jehona” ku u mor vendimi për shndërrimin e Unionit të SHKK-ve “Jehona” në një SHKK të vetme, bazuar në procesin e njohur dhe të lejuar nga nenet 55 e vijues të ligjit 52/2016. Në bazë të këtij vendimi dhe nenit 55 të ligjit Nr. 52 “Për Shoqëritë e Kursim Kreditit” Unioni i Shoqërive të Kursim Kreditit “Jehona” dhe SHKK-ja ekzistuese “NewCred” do të shndërrohen pa likuidim në një SHKK të vetme të quajtur “Unifin” SHKK.

Vendimi për shndërrimin e Unionit të SHKK-ve “Jehona” në Shoqëri Kursim Krediti “UniFin” dhe revokimin e licences të SHKK Newcred, është aprovuar nga Banka e Shqipërisë sipas shkresës Nr. Prot. 6605/5 datë 14.04.2017.

Unifin SHKK u licensua nga Banka e shqipërise për të vepruar si Shoqëri Kursim Krediti në datë 14 Korrik 2017.

Anëtarët e Shoqërisë së kursim kreditit janë individë, persona fizikë ose juridikë, të cilët depozitojnë kursimet e tyre dhe marrin hua nëpërmjet shoqërisë dhe që pranojnë aktet nënligjore të miratuara nga Shoqëritë e Kursim-Kreditit.

Objekti kryesor i veprimtarisë së Shoqërisë është kryerja e aktiviteteve financiare si dhenie kredie dhe pranimit e depozitave nga anëtarët e shoqërisë së kursim-kreditit në lekë dhe në valute të huaja, në përputhje me kushtet e përcaktuara. Shoqëria mund të ushtrojë edhe veprimtari të tjera, të cilat janë të lidhura me objektin kryesor të veprimtarisë së saj.

Unifin SHKK udhëhiqet dhe mbikqyret nga Këshilli Drejtues si dhe Komiteti i Kontrollit:

Zyrat qendrore të Unifin SHKK janë në Rrugë George W. Bush, Pallati Nr. 29, apartamenti Nr. 3, Tiranë.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave

2.1 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

Pasqyrat financiare paraqiten në Lek, e cila është monedha funksionale për Unifin SHKK.

Transaksionet në monedhë të huaj regjistrohen me kursin zyrtar të këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare të mbajtura në monedhë të huaj konvertohen sërish me kursin zyrtar të datës së bilancit. Të gjitha diferencat regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(i) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (“BSNK”).

(ii) Paraqitja e pasqyrave financiare

Shoqëria e paraqet pasqyrën e pozicionit financiar kryesisht sipas rendit të likuiditetit. Një analizë lidhur me arketimin ose shlyerjen brenda 12 muajve pas dates së raportimit (korrente), dhe me vone se 12 muaj nga data e pasqyrave financiare (jo Korrente) paraqitet në shënimin 20.

Aktivitetet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur dhe vetëm kur Shoqëria gëzon të drejtën ligjore për të bërë kompensimin e shumave dhe vlerave, dhe ka si qëllim likuidimin mbi bazën neto ose likuidimin e aktivitetit dhe shlyerjen e detyrimit njëkohësisht. Te ardhurat dhe shpenzimet nuk paraqiten neto vetëm nëse lejohen nga standardet e kontabilitetit ose interpretimet, dhe siç shpjegohet në mënyrë specifike në politikat kontabël të Shoqërisë.

2.2 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Gjatë procesit të aplikimit të politikave kontabël të Shoqërisë, drejtimi ka ushtruar gjykim dhe vlerësim në përcaktimin e shumave të njohura në pasqyrat financiare. Përdorimet më të rëndësishme të gjykimeve dhe vlerësimeve janë si vijon:

(i) Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të vijueshmërisë dhe nuk përfshijnë ndonjë korrigjim që mund të rezultojë nga kjo çështje. Drejtimi nuk është në dijeni të ndonjë pasigurie materiale që mund të sjellë dyshime mbi mundësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi.

2.3 Zbatimi i standardeve ndërkombëtare të reja dhe të rishikuara të raportimit financiar

2.3.1 Standarde, interpretime dhe amendime efektive në periudhën aktuale

Politikat kontabël të adoptuara janë konsistente me politikat e vitit të mëparshëm me përjashtim të SNRF-ve të ndryshuara, të cilat janë adoptuar nga Shoqëria në datën 1 janar 2019:

- **SNRF 16 Qiratë**
- **KIRFN 23 Interpretimi - Pasiguria mbi trajtimin e tatimit mbi te ardhurat**
- **Ndryshime të SNRF 9: Elementë parapagimi me kompensim negativ**
- **Ndryshimet në SNK 19: Ndryshime të skemës, shkurtime, ose shlyerja**
- **Ndryshimet në SNK 28: Interesat afatgjatë në pjesëmarrjet dhe sipërmarrjet e përbashkëta**
- **Përmirësime vjetore të SNRF-ve: cikli 2015-2017**

Natyra dhe ndikimi i çdo standardi dhe ndryshimi është përshkruar në vazhdim:

2.3.1 Standarde, interpretime dhe amendime efektive në periudhën aktuale (vazhdim)

- SNRF 16 Qiratë

BSNK publikoi standardin e ri për kontabilizimin e qirave - SNRF 16 Qiratë në Janar 2016. Standardi i ri nuk ndryshon shumë kontabilizimin e qirave nga qiradhënesit. Megjithatë, kërkon që qiramarrësit të njohin në bilancin e tyre kontabël pothuajse të gjitha qiratë si detyrime për qira bashkë me aktivet korresponduese në aktiv. Qiramarrësit duhet të përdorin një model të vetëm për njohjen e të gjitha qirave, por do të kenë opsionin të mos njohin qiratë afatshkurtra ose qiratë për aktive me vlera të vogla. Në përgjithësi, modeli i njohjes do jetë i ngjashëm me atë që përdoret aktualisht për kontabilizimin e qirave financiare, me interesin dhe shpenzimin e amortizimit të njohur në zëra të vecantë në pasqyrën së fitimit ose humbjes. SNRF 16 hyn në fuqi për periudhat që fillojnë më ose pas 1 Janar 2019. Shoqëria nuk e ka adoptuar SNRF 16 në vitin aktual. Shpenzimet e qirave njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në mënyrë lineare përgjatë periudhës së qirasë.

- KIRFN 23 Interpretimi - Pasiguria mbi trajtimin e tatimit mbi të ardhurat

Interpretimi trajton kontabilitetin për tatimin mbi të ardhurat kur trajtimet tatimore përfshijnë pasiguri që ndikojnë në zbatimin e SNK 12 dhe nuk zbatohet për tatimet ose taksat jashtë fushëveprimit të SNK 12 dhe as nuk përfshin në mënyrë specifike kërkesa lidhur me interesa dhe penaltitete që lidhen me trajtimin e pasigurt tatimor. Interpretimi trajton në mënyrë specifike sa vijon:

- Nëse një njësi ekonomike i konsideron trajtimet e pasigurta tatimore veç e veç.
- Supozimet që një njësi ekonomike bën në lidhje me ekzaminimin e trajtimeve tatimore nga autoritetet tatimore
- Si një njësi ekonomike përcakton fitimin e tatueshëm (humbje tatimore), bazat tatimore, humbjet tatimore të papërdorura, kreditë tatimore të papërdorura dhe normat tatimore
- Si një njësi ekonomike i konsideron ndryshimet në fakte dhe rrethana.

Një njësi ekonomike duhet të përcaktojë nëse duhet të konsiderojë çdo trajtim tatimor të pasigurt veçmas ose së bashku me një ose më shumë trajtime të tjera të pasigurta tatimore. Duhet të ndiqet qasja që parashikon më mirë zgjidhjen e pasigurisë. Interpretimi është efektiv për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2019. Ky ndryshim nuk është i aplikueshem për Shoqërinë.

- Ndryshime të SNRF 9: Elementë parapagimi me kompensim negativ

Sipas SNRF 9, një instrument borxhi mund të matet me koston e amortizuar ose me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, me kusht që flukset monetare kontraktuale të jenë “vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën e principalit të mbetur” (kriteri i SPPI) dhe instrumenti mbahet brenda një model biznesi të përshtatshëm për këtë klasifikim. Ndryshimet në SNRF 9 sqarojnë se një aktiv financiar kalon kriterin e SPPI pavarësisht nga ngjarja ose rrethana që shkakton ndërprerjen e parakohshme të kontratës dhe pavarësisht se cila pale pagan ose merr kompensim të arsyeshëm për përfundimin e parakohshëm të kontratës. Ndryshimet duhet të zbatohen në mënyrë retrospektive dhe hyjnë në fuqi që nga 1 janari 2019, aplikimi i më hershëm është i lejueshëm. Ky ndryshim nuk ka efekt material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

- Ndryshimet në SNK 19: Ndryshime të skemës, shkurtimet, ose shlyerja e planit

Ndryshimet në SNK 19 adresojnë kontabilitetin kur ndodh një ndryshim, shkurtim ose shlyerje plani gjatë një periudhe raportuese. Ndryshimet standardit specifikojnë se kur një ndryshim, shkurtim ose shlyerje plani ndodh gjatë periudhës raportuese vjetore, një njësi ekonomike duhet të:

- Përcaktojë koston aktuale të shërbimit për pjesën e mbetur të periudhës pas ndryshimit të skemës, shkurtimit ose shlyerjes, duke përdorur supozimet aktuale të përdorura për rivlerësimin e detyrimit (aktivin) neto të përfitimit të përcaktuar që reflekton përfitimet e ofruara sipas skemës dhe aktivet e skemës pas asaj ngjarjeje

2.3.1 Standarde, interpretime dhe amendime efektive ne periudhen aktuale (vazhdim)

- Ndryshimet në SNK 19: Ndryshime të skemës, shkurtime, ose shlyerja e planit (vazhdim)

- Përcaktojë interesin neto për pjesën e mbetur të periudhës pas ndryshimit, shkurtimeve ose shlyerjes të skemës duke përdorur: detyrimin (aktivin) neto të përfitimeve të përcaktuara që pasqyrojnë përfitimet e ofruara sipas skemës dhe aktiveve të skemës pas asaj ngjarjeje; dhe normën e skontimit të përdorur për të rimatur atë detyrim (aktiv) neto të përfitimeve të përcaktuara.

Ndryshimet gjithashtu sqarojnë se një njësi ekonomike përcakton së pari çdo kosto të shërbimit të shkuar, ose një fitim ose humbje nga shlyerja, pa marrë parasysh efektin e tavanit të aktivitetit. Kjo shumë njihet në fitim ose humbje. Një njësi ekonomike pastaj përcakton efektin e tavanit të aktivitetit pas ndryshimit, shkurtimeve ose shlyerjes të skemës. Çdo ndryshim në këtë efekt, duke përjashtuar shumën e përfshira në interesin neto, njihet në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse. Ndryshimet zbatohen për ndryshimet, shkurtimeve ose shlyerjen e planit që ndodhin në ose pas fillimit të periudhës së parë të raportimit vjetor që fillon më ose pas 1 janarit 2019.

Ky ndryshim nuk ka efekt në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

- Ndryshimet në SNK 28: Interesat afatgjatë në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta

Ndryshimet sqarojnë që një njësi ekonomike zbaton SNRF 9 për interesat afatgjatë në një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët në të cilën nuk aplikohet metoda e kapitalit neto, por që në thelb përbën një pjesë të investimit neto në pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët (interesa afatgjatë). Ky sqarim është i rëndësishëm sepse nënkupton që modeli i prituri i humbjes së kredisë në SNRF 9 zbatohet për interesat të tilla afatgjatë. Ndryshimet gjithashtu sqaruan se, në zbatimin e SNRF 9, një njësi ekonomike nuk merr parasysh humbjet e pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët, ose ndonjë humbje nga zhvlerësimi në investimet neto, të njohura si rregullime të investimit neto në pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët që lindin nga zbatimi i SNK 28 Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta. Amendamentet duhet të zbatohen në mënyrë retrospektive dhe janë në fuqi nga 1 janari 2019. Megjithatë Shoqëria nuk ka interesat të tilla afatgjatë në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta, ndryshimet nuk kanë ndikim në pasqyrat e saj financiare.

- Përmirësime vjetore të SNRF-ve, Cikli 2015-2017 (leshuar ne Dhjetor 2017)

Këto përmirësime përfshijnë:

- SNRF 3 Kombinimet e biznesit

Ndryshimet sqarojnë se kur një njësi ekonomike merr kontrollin e një biznesi që është një operacion i përbashkët, ajo zbaton kërkesat e një kombinimi biznesi të arritur në fazë, duke përfshirë rivlerësimin e interesave të mbajtura më parë në aktivet dhe pasivet e operacioneve të përbashkëta me vlerë të drejtë. Duke vepruar kështu, blerësi e rimat të gjithë interesin e mbajtur më parë në operacionin e përbashkët. Një njësi ekonomike zbaton këto ndryshime në kombinimet e biznesit për të cilat data e blerjes është në ose pas fillimit të periudhës së parë të raportimit vjetor që fillon më ose pas 1 janarit 2019. Këto ndryshime do të zbatohen për kombinimet e ardhshme të biznesit të Shoqërisë.

- SNRF 11 Marrëveshjet e përbashkëta

Një palë që merr pjesë, por nuk ka kontroll të përbashkët në një operacion të përbashkët, mund të marrë kontroll të përbashkët të veprimtarisë e cila përbën një biznes siç përcaktohet në SNRF 3. Amendamentet sqarojnë se interesat e mbajtura më parë në atë operacion të përbashkët nuk rimaten. Një njësi ekonomike zbaton këto ndryshime në transaksionet në të cilat ajo fiton kontroll të përbashkët në ose pas fillimit të periudhës së parë të raportimit vjetor që fillon në ose pas 1 janarit 2019. Këto ndryshime aktualisht nuk janë të zbatueshme për Shoqërinë, por mund të zbatohen për transaksionet e ardhshme.

2.3.1 Standarde, interpretime dhe amendime efektive ne periudhen aktuale (vazhdim)

- SNK 12 Tatimi mbi Fitimin

Ndryshimet sqarojnë se pasojat e tatimit mbi të ardhurat e dividendëve lidhen më drejtpërdrejt me transaksionet e mëparshme ose ngjarjet që gjenerojnë fitime të shpërndara sesa me shpërndarjet tek pronarët. Prandaj, njësia ekonomike njeh pasojat e tatimit mbi të ardhurat e dividendëve në fitim ose humbje, të ardhura të tjera gjithëpërfshirë ose kapital sipas menyres se ku njësia ekonomike fillimisht i ka njohur ato transaksione ose ngjarje të mëparshme. Njësia ekonomike zbaton këto ndryshime për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019. Kur një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për herë të parë, ajo i zbaton ato tek tatimi mbi të ardhurat i dividendëve të njohur në ose pas fillimit të periudhës më të hershme krahasuese. Këto ndryshime aktualisht nuk janë të zbatueshme për Shoqërinë.

- SNK 23 Kostot e Huamarrjes

Ndryshimet sqarojnë që një njësi ekonomike trajton si pjesë e huamarrjes së përgjithshme çdo huamarrje të bërë fillimisht për të zhvilluar një aktiv të kualifikuar kur në tërësi të gjitha aktivitetet e nevojshme për përgatitjen e atij aktivi për përdorimin ose shitjen e synuar janë të perfunduara. Një njësi ekonomike zbaton këto ndryshime në kostot e huamarrjes të bëra në ose pas fillimit të periudhës raportuese vjetore në të cilën njësia ekonomike i zbaton këto ndryshime. Një njësi ekonomike zbaton këto ndryshime për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë në ose pas 1 janarit 2019. Këto ndryshime aktualisht nuk janë të zbatueshme për Shoqërinë, por mund të zbatohen për transaksionet e ardhshme.

- Ligji i ri për Kontabilitetin në Shqipëri

Në vijim të punës që po bën qeveria shqiptare në rrugën drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar më datë 10 maj 2018 ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” (më poshtë “Ligji i ri për kontabilitetin” ose “Ligji i ri”), i cili shfuqizon ligjin e mëparshëm nr. 9228, datë 29.4.2004. Ligji i ri për kontabilitetin është përafëruar pjesërisht me Direktivën 2013/34 të Bashkimit Evropian dhe qëllimi është përafërimi i plotë i tij në vitin 2028. Ligji i ri hyri në fuqi më datë 1 janar 2019. Aplikimi i Ligjit të ri i detyron Shoqëritë me interes publik ku Shoqëria përfshihet të raortojnë pasqyra financiare të përgatitura në baza të SNRF.

2.3.2 Standarde dhe interpretime të reja që nuk kanë hyrë ende në fuqi dhe ende nuk janë zbatuar përpara datës efektive

Standardet dhe interpretimet e emetuara, por që nuk kanë hyrë ende në fuqi, deri në datën e deklarimit të pasqyrave financiare të Shoqërisë, janë pasqyruar më poshtë. Shoqëria synon të adoptojë këto standarde, nëse janë të aplikueshme, kur ato të bëhen efektive.

- SNRF 17 Kontratat e Sigurimit

Në Maj 2017, BSNK publikoi SNRF 17 Kontratat e Sigurimit (SNRF17), një standard i ri kontabël gjithëpërfshirës për kontratat e sigurimeve që mbulon njohjen dhe matjen, prezantimin dhe shënimet shpjeguese. Pasi të bëhet efektiv, SNRF 17 do të zëvendësojë SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve (SNRF 4) që është nxjerrë në vitin 2005. SNRF 17 zbatohet për të gjitha llojet e kontratave të sigurimit (dmth., jetë, jo-jetë, sigurimi i drejtpërdrejtë dhe risigurimi), pavarësisht nga lloji i subjekteve që i lëshojnë ato, si dhe për disa garanci dhe instrumente financiare me karakteristika të pjesëmarrjes diskrecionare. Do të ketë disa përjashtime nga objektivi. Objektivi i përgjithshëm i SNRF 17 është të sigurojë një model kontabiliteti për kontratat e sigurimit që të jetë më i dobishëm dhe i qëndrueshëm për siguruesit. Në kontrast me kërkesat e SNRF 4, të cilat bazohen kryesisht në politikat e mëparshme të kontabilitetit, SNRF 17 ofron një model gjithëpërfshirës për kontratat e sigurimeve, duke mbuluar të gjitha aspektet përkatëse të kontabilitetit. SNRF 17 hyn në fuqi për periudhat që fillojnë më ose pas 1 Janar 2021 dhe zbatimi i tij kërkon paraqitjen e vlerave krahasuese të periudhave të mëparshme. Aplikimi i më hershëm është i lejueshëm me kusht që Shoqëria të aplikojë SNRF 9 dhe SNRF 15 më ose përpara datës së aplikimit të SNRF 17. Ky standard nuk është i aplikueshëm për Shoqërinë.

2.3.2 Standarde dhe interpretime të reja që nuk kanë hyrë ende në fuqi dhe ende nuk janë zbatuar përpara datës efektive (vazhdim)

- Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8: Përkufizimi i materialitetit

Në tetor 2018, BSNK publikoi ndryshimet e SNK 1 Paraqitja e pasqyrave financiare dhe SNK 8 Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet për të përafshuar përkufizimin e ‘materialitetit’ ndërmjet standardeve dhe për të sqaruar disa aspekte të përkufizimit. Përkufizimi i ri shprehet se ‘informacioni është material nëse përjashtimi, deklarimi i gabuar ose fshehja e tij mund të ndikojë në mënyrë të arësyeshme vendimet që përdoruesit kryesorë të pasqyrave financiare të përgjithshme marrin bazuar në ato pasqyra financiare, të cilat japin informacion mbi një njësi specifike.

- Ndryshimet në SNRF 3: Përkufizimi i biznesit

Në tetor 2018, BSNK publikoi ndryshimet në përkufizimin e biznesit në SNRF 3 Kombinimet e biznesit për të ndihmuar njësitë të përcaktojnë nëse një set aktivesh të përvetësuar përbën një biznes ose jo. Aty sqarohet minimumi i kërkesave për një biznes, hiqet vlerësimi nëse një pjesëtar i tregut është në gjendje të zëvendësojë ndonjë element që mungon, dhe shtohen udhëzimet për të ndihmuar njësitë të vlerësojnë nëse një proces i përvetësuar është thelbësor, ngushton përkufizimet e biznesit dhe rezultateve, dhe prezanton një test opsional të përqëndrimit të vlerës së drejtë. Shembuj të rinj ilustrues janë prezantuar bashkë me ndryshimet. Shoqëria nuk do të ndikohet nga këto ndryshime në datën e tranzicionit.

- Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28: Shitja ose kontributi i Aktiveve nga investitori tek pjesëmarrja e tij ose sipërmarrja e përbashkët

Ndryshimet adresojnë konfliktin midis SNRF 10 dhe SNK 28 për trajtimin e humbjes së kontrollit mbi një filial që shitet ose kontribuohet tek një pjesëmarrje ose sipërmarrje e përbashkët. Ndryshimet sqarojnë se fitimi ose humbja që rezulton nga shitja ose kontributi i aktiveve që përbëjnë një biznes, siç përcaktohet në SNRF 3, nga investitori tek pjesëmarrja e tij ose sipërmarrja e përbashkët, njihet plotësisht. Çdo fitim ose humbje që rezulton nga shitja ose kontributi i aktiveve që nuk përbëjnë një biznes, njihet vetëm në masën e interesave të investitorëve të palidhur në pjesëmarrjen ose sipërmarrjen e përbashkët. BSNK ka shtyrë datën efektive të këtyre ndryshimeve për një kohë të pacaktuar, por një njësi ekonomike që i aplikon ndryshimet me heret duhet t'i zbatojë ato në mënyrë prospektive. Drejtimi ka vlerësuar se adoptimi i këtij ndryshimi nuk do të ketë ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Shoqëria ka zgjedhur të mos i implementojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave efektive të tyre. Shoqëria parashikon që adoptimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë në periudhën e aplikimit fillestar.

3 Përmbledhje e politikave kontabël

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Gjatë hartimit të pasqyrave financiare, transaksionet në monedha të ndryshme nga monedha funksionale e Shoqërisë, janë njohur duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale të veprimtarisë me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Në çdo datë raportimi, aktivet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedhë të huaj rivlerësohen në Lekë me kursin në datën e raportimit.

Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës të rregulluara me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në monedhën funksionale me kursin e fund-vitit. Aktivet jo monetare dhe detyrimet maten në kosto historike të monedhave të huaja dhe këmbehen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

“UNIFIN” Shoqëri Kursim Krediti
31 Dhjetor 2019
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(Të gjitha shumat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

3.1 Transaksionet ne monedhe te huaj (vazhdim)

Kurset e këmbimit të aplikueshme (Lekë ndaj një njësie të monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
1 USD	108.64	107.82
1 EUR	121.77	123.42

3.2 Mjetet monetare

Aktivitet monetare dhe ekuivalentet me to përfshijnë kartëmonedha dhe monedha, shuma të pakushtëzuara me Bankën Qendrore dhe investimet me likuiditet të lartë të cilat kanë maturim tre mujor ose më të vogël, të cilat janë subjekt i rreziqeve të parëndësishme të ndryshimit të vlerës së drejtë dhe përdoren nga Shoqëria në menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra. Aktivitet monetare dhe ekuivalentet me to mbarten me koston e amortizimit në pasqyrën e pozicionit financiar.

3.3 Instrumentet financiare – njohja fillestare dhe matja vijuese

3.3.1 Data e njohjes

Të gjithë aktivitet dhe detyrimet financiare janë njohur fillimisht në datën kur Shoqëria bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit.

3.3.2 Matja fillestare e instrumenteve financiare

Shoqëria fillimisht njeh huatë dhe paradhëniet, detyrimet për hua në datën kur ato janë krijuar. Të gjitha aktivitet dhe detyrimet e tjera financiare (përfshirë aktivitet dhe detyrimet që maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes) njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën Shoqëria bëhet palë për respektimin e dispozitave kontraktuale të instrumentit.

Një aktiv ose detyrim financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë.

Kostot e transaksionit të cilat i atribuohen direkt blerjes së tij ose emetimit të aktiveve apo detyrimeve financiare (për një zë i cili nuk matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes) i shtohen ose zbriten vlerës së drejtë të aktiveve apo detyrimeve financiare, sipas rastit, në njohjen fillestare. Kostot e transaksionit që i atribuohen në mënyrë direkte blerjes së aktiveve apo detyrimeve financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes njihen menjëherë në fitim ose humbje.

3.3.3 Klasifikimi i aktiveve financiare

Aktivitet financiare klasifikohen në kategoritë e mëposhtme të specifikuara:

Duke filluar nga 01 janari 2018 aktivitet financiare klasifikohen në kategoritë e mëposhtme sipas SNRF 9-te.

- Instrumente borxhi me kosot te amortizueshme
- Aktive me vlere te drejte nepermjet fitim humbjes
- Instrumente borxhi/ Aktive me vlere te drejte OCI

Klasifikimi varet nga natyra dhe qëllimi i aktiveve financiare dhe përcaktohet gjatë njohjes fillestare. Të gjitha blerjet në mënyrë të rregullt ose shitjet e aktiveve financiare njihen dhe çregjistrohen mbi bazën e datës së tregtimit. Blerjet ose shitjet e rregullta janë blerjet ose shitjet e aktiveve financiare që kërkojnë shpërndarjen e aktiveve brenda afateve kohore të përcaktuara në rregulloret ose konventat në treg.

3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

3.3 Instrumentet financiare – njohja fillestare dhe matja vijuese (vazhdim)

3.3.4 Klasifikimi i detyrimeve financiare dhe kapitalit

Klasifikimi si borxh ose kapital

Instrumentat e borxhit dhe kapitalit të emetuar nga Shoqëria janë klasifikuar ose si detyrime financiare ose si kapital i vet në përputhje me thelbin e marrëveshjeve kontraktuale dhe përkufizimeve të detyrimit financiar dhe instrumentave të kapitalit.

Instrumentat e kapitalit

Një instrument kapitali është çdo kontratë që evidenton një interes të mbetur në aktivet e Shoqërisë pas zbritjes së të gjitha detyrimeve të saj. Instrumentat e kapitalit neto të emetuara nga Shoqëria janë të njohura për shumën e arkëtuar, neto nga kostot direkte të emetimit.

3.3.5 Hua dhe paradhënie klienteve

Hua dhe paradhënie për klientët përfshijnë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv, dhe që Shoqëria nuk ka ndërmend t'i shesë menjëherë ose në të ardhmen e afërt, përveç:

- Atyre që Shoqëria ka për qëllim t'i shesë menjëherë ose në të ardhmen e afërt dhe atyre që Shoqëria gjatë njohjes fillestare i përcakton si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes;
- Atyre që Shoqëria, gjatë njohjes fillestare, i përcakton si të vlefshme për shitje.

3.3.6 Letrat me vlerë të investimit

Letrat me vlerë të investimit kontabilizohen në varësi të klasifikimit të tyre, ose si të mbajtura deri në maturim, me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, ose të vlefshme për shitje.

Instrumenta financiarë të mbajtur deri në maturim

Investimet e mbajtura deri në maturim janë aktive jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe maturitet fiks të cilat Banka ka qëllimin dhe mundësinë t'i mbajë deri në maturim dhe të cilat nuk janë dizenuar me vlerë të drejtë në fitim ose humbje ose të vlefshme për shitje. Pas njohjes fillestare, investimet e mbajtura deri në maturim mbarten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm. Nëse Shoqëria do të shesë ose riklasifikojë para maturimit një shumë të rëndësishme të letrave me vlerë të mbajtura deri në maturim (përveçse në rrethana të caktuara specifike), e tërë kategoria do të “njolloset” dhe do të duhej të riklasifikohet si e vlefshme për shitje. Për më tepër, Shoqëria do ta kishte të ndaluar klasifikimin e ndonjë aktivi financiar si të mbajtur deri në maturim gjatë dy viteve në vijim.

Instrumentat financiarë të vlefshëm për shitje

Investimet e vlefshme për shitje janë investime jo-derivative që nuk dizenuohen si një kategori tjetër e aktiveve financiare. Investimet e kapitalit të pakuotuar, vlera e drejtë e të cilave nuk mund të matet në mënyrë të besueshme, mbarten me kosto. Të gjitha investimet e vlefshme për shitje mbarten me vlerë të drejtë.

Të ardhurat nga interesi, përveç interesave të kredive të dhena anetareve, njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet ose humbjet nga kursi i këmbimit në investimet e borxhit të vlefshme për shitje, njihen direkt në humbje ose fitim. Ndryshime të tjera të vlerës së drejtë njihen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse deri kur investimi të jetë shitur ose zhvlerësuar dhe fitimi ose humbja e akumuluar të njihet në fitim ose humbje.

3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

3.4 Mosnjohja (çregjistrimi) e aktiveve dhe detyrimeve financiare

3.4.1 Aktivet financiare

Shoqëria nuk e njeh më një aktiv financiar (e çregjiston) nëse të drejtat kontraktuale për përfitimin e parave nga aktivi janë shuar, ose nëse transferohen të drejtat për të marrë përfitimin kontraktual nga aktivi financiar në një transaksion nëpërmjet të cilit transferohen te një njësi tjetër të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin financiar. Çdo interes në aktivet financiare të transferuara që krijohet ose mbahet nga Shoqëria njihet si një aktiv ose detyrim më vete.

3.4.2 Detyrimet financiare

Shoqëria çregjiston detyrimet financiare kur, dhe vetëm kur, detyrimet e Shoqërisë janë shkarkuar, anuluar ose kanë skaduar. Diferenca midis vlerës kontabël neto të detyrimit financiar të çregjistruar dhe shumës së paguar dhe të pagueshme njihet në fitim ose humbje. Një aktiv ose detyrim njihet për të drejtat e shërbimit, në qoftë se tarifa e shërbimit është më e lartë se shpenzimet e shërbimit (aktiv) ose është më pak se e përshtatshme për të kryer shërbimin (detyrim).

3.5 Përcaktimi i vlerës së drejtë

Vlera e drejtë është shuma për të cilën një aktiv mund të këmbëhet ose një detyrim të shlyhet midis palëve të palidhura me njëra-tjetrën, të mirinformuara që kryejnë një transaksion në mënyrë të vullnetshme në datën e matjes.

Kur është e mundur, Shoqëria e mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimet e kuotuar të një tregu aktiv për atë instrument. Një treg konsiderohet aktiv nëse çmimet e kuotuar janë lehtësisht dhe rregullisht të disponueshme dhe paraqesin transaksione të tregut aktual që kryhen në mënyrë të rregullt dhe në kushte të barabarta. Një teknikë vlerësimi e përdorur nga Shoqëria për të identifikuar nëse për një instrument financiar ekziston një treg aktiv është ekzistenca e çmimeve të kuotuar për aktive dhe/ose detyrime të ngjashme, të cilat Shoqëria mund t'i aksesojë në datën e raportimit. Nëse tregu për një instrument financiar nuk është aktiv, Shoqëria kryen matjen me vlerën e drejtë duke përdorur teknika vlerësimi.

Evidence më e mirë për vlerën e drejtë të një instrumenti financiar në matjen fillestare është çmimi i transaksionit, p.sh. vlera e drejtë e dhënë ose e marrë, vetëm nëse vlera e drejtë e atij instrumenti është evidentuar nga krahasimi me transaksione aktuale të tregut për instrumenta të njëjtë (p.sh., pa modifikime ose ripaketim) ose e bazuar në metodat e vlerësimit në të cilat variablat përfshijnë vetëm të dhëna të vëzhgueshme në tregje. Kur çmimet e transaksioneve paraqesin evidencën më të mirë të vlerës së drejtë në njohjen fillestare, instrumenti financiar matet fillimisht me çmimin e transaksionit dhe çdo diferencë midis këtij çmimi dhe vlerës fillestare të përfutur nga një model vlerësimi është njohur më pas në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme mbi jetën e instrumentit por jo më vonë se vlerësimi të mbështetet tërësisht nga të dhëna të vëzhgueshme në treg ose transaksioni të mbyllet.

Shoqëria e mat vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e mëposhtme që reflekton rëndësinë e input-eve të përdorura gjatë matjeve:

- Niveli 1: çmimet e kuotuar (te pakorrigjuara) të një tregu aktiv për një instrument identik.
- Niveli 2: Teknika vlerësimi bazuar në input-e të vëzhgueshme, ose në mënyrë direkte (si p.sh. çmimet), ose në mënyrë indirekte (që rrjedh nga çmimet). Kjo kategori përfshin instrumenta të vlerësuar duke përdorur: çmime të kuotuar në tregje aktivë për instrumenta identikë ose të ngjashëm, çmime të kuotuar për instrumenta identikë ose të ngjashëm në tregje që konsiderohen jo aq aktivë; ose teknika të tjera vlerësimi ku gjithë input-et kryesore mund të vëzhgohen në mënyrë direkte ose indirekte nga të dhënat e tregut.

3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

3.5 Percaktimi i vleres së drejte (vazhdim)

- Niveli 3: Teknika vlerësimi duke përdorur input-e të rëndësishme jo të vëzhgueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë instrumentat ku teknika e vlerësimit përfshin input-e që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe input-et jo të vëzhgueshme kanë një ndikim të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumenta që vlerësohen mbi bazën e çmimeve të kuotuarra për instrumenta të ngjashëm ku kërkohen korrigjime të rëndësishme jo të vëzhgueshme ose supozime për të reflektuar diferencat mes instrumentave.

3.6 Kreditë

Kreditë u jepen anëtarëve të Unifin SHKK si një formë e drejtpërdrejtë financimi dhe mbahen me kosto të amortizuar. Të gjitha kreditë njihen kur mjetet monetare i transferohen anëtarëve.

Kreditë mbahen duke i zbritur provizionin për rënie në vlerë të kredive. Provizionin për rënie në vlerë përcaktohet nëse ka të dhëna objektive që Unifin SHKK nuk do të mund të mbledhë shumat përkatëse. Kur një kredi është e pambledhshme, ajo çregjistrohet kundrejt provigjonit përkatës për rënien në vlerë. Rimarrjet e mëpasshme kreditohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Provizionet krijohen në bazë të vendimit Nr. 105 të bankës së Shqipërisë për miratimin e rregullores “Për administrimin e riskut në veprimtarinë e Shoqërive të kursim kreditit dhe unioneve të tyre” të aprovuar nga Këshilli i Mbikqyrjes më 5 Tetor 2016.

Unifin ka aplikuar përqindjet minimale në vijim për secilën kategori risku të përcaktuar në rregulloren e administrimit të rrezikut, në lidhje me kreditë e dhëna ndaj anëtarëve:

Kategoria e kreditë	Normat e provigjonimit
Standarde (0-30 ditëvonesë)	2%
Në ndjekje (31-90 ditë vonesë)	15%
Nën standarde (91-180 ditë vonesë)	40%
Të dyshimta (181-365 ditëvonesë)	75%
Të humbura (mbi 365 ditë vonesë)	100%

3.7 Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e aktivitetit. Kostot e aktiveve të ndërtuara vetë përfshijnë kostot e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër që lidhet me vënien e aktivitetit në punë për qëllimin e përcaktuar dhe kostot e çmontimit dhe lëvizjes dhe ristrukturimit në vendin në të cilin ato ndodhen. Programi kompjuterik i blerë, i cili është një pjesë integrale e funksionimit të pajisjes kontabilizohet si pjesë e pajisjes. Kur pjesët e një zëri të ndërtesës dhe pajisjeve kanë jetë përdorimi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndarë (komponentët kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale. Një shpenzim i mëvonshëm kapitalizohet vetëm kur është e mundur që në të ardhmen përfitimet ekonomike nga shpenzimi do të përfitohen nga Shoqëria. Riparimet dhe mirëmbajtja e vazhdueshme njihen si shpenzime kur ato ndodhin.

Kostot vijuese

Kostoja e pjesëve të zëvendësuara të tokës, ndërtesës dhe pajisjeve njihet me vlerën e mbartur nëse është e mundshme që në të ardhmen Shoqëria do të ketë përfitime ekonomike nga këto pjesë dhe kostot e tyre mund të njihen në mënyrë të besueshme. Kostot e mirëmbajtjes së përditshme njihen në fitim ose humbje në momentin kur lindin.

3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

3.7 Aktive afatgjata materiale

Amortizimi

Amortizimi njihet në të ardhura dhe shpenzimeve me anën e metodës lineare mbi jetën e dobishme të vlerësuar të aktivit. Toka nuk zhvlerësohet. Metodat e zhvlerësimit, jeta e dobishme dhe vlerat e mbetura rivlerësohen në datën e raportimit. Norma e amortizimit për periudhën aktuale dhe krahasuese është 10%.

Përmirësimet e ambienteve të marra me qira lidhen me shpenzime për rinovim zyresh dhe regjistrohen si aktive të tjera. Këto aktive amortizohen përgjatë periudhës së qirasë.

3.8 Aktivet afatgjata jo-materiale

Aktivitet afatgjata jo-materiale përfshijnë liçencat për programe të blera nga Shoqëria dhe maten me koston historike të zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga renia në vlere. Shpenzimet e mëvonshme mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik prej këtij mjeti. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin.

Amortizimi njihet në fitim ose humbje me normën 10% mbi koston historike prej datës në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim.

3.9 Qiratë

Totali i pagesave të kryera në saj të qirave njihen si shpenzim operativ në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në mënyrë lineare përgjatë periudhës së qirasë.

3.10 Kapitali

Kapitali i Unifin SHKK përbëhet nga kontributet e anetareve, donacionet, rezervat e krijuara dhe fitimet ose humbjet e mbartura. Kontributet e anetareve janë shumat e paguara në kapitalin e SHKK-se nga çdo anëtar i SHKK-se si kusht për anëtarësimin në të. Vlera nominale e kontributeve mund të ndryshojë me vendim të asamblesë.

3.11 Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve të interesit

Të ardhurat nga interesi i kredive njihen kur interesi arkëtohet. Në bazë të rregullores së Bankës së Shqipërisë “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e shoqërive të kursim kreditit dhe të unioneve të tyre” SHHK-të ekistuese përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, duhet të marrin masa që interesin nga kreditë ta kontabilizojnë mbi baza rritëse brenda datës 30 Qershor 2021.

Të ardhurat nga interesi i investimeve financiare dhe shpenzimet e interesit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skanton pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare gjatë jetës së mjetit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme për një periudhë më të shkurtër) për t’i barazuar me vlerën kontabël të mjetit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit vendoset duke marrë parasysh njohjen fillestare të aktiveve ose detyrimeve financiare dhe nuk rishikohet më vonë.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha shumat e paguara ose të marra në avancë, kostot e transaksionit, zbritjet dhe primet të cilat janë pjesë integrale e normës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve janë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen, ose emetimin apo nxjerrjen jashtë përdorimi të një mjeti apo detyrimi financiar. Të ardhurat dhe shpenzimet për interesat të paraqitura si fitim ose humbje përfshin interesin e aktiveve dhe detyrimeve financiare me kosto të amortizuar me normë interesi efektive.

3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

3.12 Të ardhurat dhe shpenzimet për komisione dhe tarifa

Të ardhurat dhe shpenzimet për tarifatat dhe komisionet të cilat janë pjesë integrale e normës së interesit efektiv në një mjet ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv. Të tjera tarifa dhe komisione që përfshijnë tarifa për shërbimin e llogarive, tarifa për administrimin e investimeve, komision shitje, tarifatat e vendosjes dhe përfaqësimit njihen ndërsa shërbimi i lidhur kryhet. Shpenzime të tjera për tarifatat dhe komisionet që lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh dhe shërbimi shpenzohen në momentin që ofrohen shërbimet.

3.13 Perfitimet e punonjësve

Shoqëria paguan vetëm kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Autoritetet e Sigurimeve Shoqërore janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributesh të përcaktuara për pensione. Shoqëria gjithashtu paguan edhe kontributet e detyrueshme të shërbimit shëndetësor sipas ligjeve Shqiptare. Kontributet për planin e pensionit dhe kontributet për sigurimin shëndetësor njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ato ndodhin.

3.14 Tatimi mbi të ardhurat

Unifin SHKK në bazë të ligjit nr. 52 të vitit 2016 “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre” është e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin. Unifin SHKK është vetëm subjekt i ligjit për tatimin mbi të ardhurat personale dhe ligjit për sigurimet shoqërore dhe kontributet shëndetësore.

3.15 Provizione për detyrime të kushtezuara dhe angazhime

Një provizion është njohur nëse, si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, Shoqëria ka një detyrim ligjor ose konstruktiv që mund të matet me besueshmëri, dhe është e mundur që një dalje e përfitimeve ekonomike do të kërkohej për të shlyer detyrimin. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme monetare të ardhshme me një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të pasqyrës dhe, aty ku është e përshtatshme, rreziqet specifike që lidhen me detyrimin.

Një provizion për ristrukturimin njihet kur Shoqëria ka miratuar një plan të detajuar dhe formal ristrukturimi, dhe ristrukturimi ose ka filluar ose është shpallur publikisht. Shpenzimet operative të ardhshme nuk janë provizionuar.

Një provizion për kontratat e dyshimta njihet kur përfitimet që priten të rrjedhin të Shoqëria nga një kontratë janë më të ulëta se sa kostoja e pashmangshme e përmbushjes së detyrimeve sipas kontratës. Provizioni matet me më të ultën mes vlerës aktuale të kostos së pritshme nga ndërprerja e kontratës dhe kostos së pritshme neto të vazhdimit me kontratën. Para se të njihet provizioni, Shoqëria njeh çdo humbje nga zhvlerësimi mbi aktivet e lidhura me atë kontratë.

4 Tranzicioni në SNRF

Keto pasqyra financiare për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019, janë përgatitur për herë të parë në përputhje me SNRF nga ana e Shoqërisë. Për periudhën, duke përfshirë edhe vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2018, Shoqëria ka përgatitur pasqyrat e saj financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit në Shqipëri (SKK).

Shoqëria ka përgatitur pasqyrat e saj financiare në përputhje me SNRF për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2019, së bashku me të dhënat krahasuese për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2018, sic përshkruhet në përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabel.

“UNIFIN” Shoqëri Kursim Krediti
31 Dhjetor 2019
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(Të gjitha shumat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

4 Tranzicioni ne SNRF (vazhdim)

4.1 Rakordimi i kapitalit

Kapitali ne daten e tranzicionit dhe me 31 Dhjetor 2018 mund te rakordohet me shumat e raportuara nen standardet e mepareshme si me poshte. Nuk ka pasur rregullime me date 1 Janar 2018 (data e tranzicionit):

Rakordimi i kapitalit me 31 Dhjetor 2019	SKK ne Lek	Efektet e tranzicionit ne SNRF	SNRF ne Lek
Aktivët			
Mjetet monetare	203,542,258	-	203,542,258
Bono Thesari	24,822,897	-	24,822,897
Kredi te dhena anetareve	872,872,048	-	872,872,048
Aktive afatgjata materiale	14,985,956	-	14,985,956
Aktive afatgjata jo-materiale	1,325,514	-	1,325,514
Aktive te tjera	1,465,321	-	1,465,321
Aktivët Totale	1,119,013,994	-	1,119,013,994
Detyrimet			
Depozita nga anetaret	991,439,233	-	991,439,233
Detyrime te tjera	17,543,650	-	17,543,650
Totali i detyrimeve	1,008,982,883	-	1,008,982,883
Kapitali			
Kapitali	82,461,615	-	82,461,615
Rezerva	34,760,984	-	34,760,984
Teprica/(deficit) i mbartur	(7,191,488)	-	(7,191,488)
Totali i kapitalit	110,031,111	-	110,031,111
Totali i detyrimeve dhe kapitalit	1,119,013,994	-	1,119,013,994

“UNIFIN” Shoqëri Kursim Krediti
31 Dhjetor 2019
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(Të gjitha shumat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

4 Tranzicioni ne SNRF (vazhdim)

4.2 Rakordimi i i te ardhurave gjithëpërshiresë

Totali i te ardhurave gjithëpërshiresë per periudhen e raportimit qe mbyllet me 31 Dhjetor 2018, mund te rakordohet me shumat e raportuara nen standardet e meparshme si me poshte:

Rakordimi i te ardhurave gjithëpërshiresë me 31 Dhjetor 2018	SKK ne Lek	Efektet e tranzicionit ne SNRF	SNRF ne Lek
Te ardhura nga interesi	120,940,725	-	120,940,725
Shpenzime interesi	(29,984,380)	-	(29,984,380)
Te ardhura neto nga intereso	90,956,345	-	90,956,345
Shpenzimet e provizionit	(9,759,175)	-	(9,759,175)
Te ardhura neto pas zhvleresimit te huave	81,197,170	-	81,197,170
Te ardhura nga kthimi i kredive te fshira	4,056,561	-	4,056,561
Te ardhura te tjera	1,878,324	-	1,878,324
Te ardhura te tjera	5,934,885	-	5,934,885
Shpenzime personeli	(50,398,336)	-	(50,398,336)
Shpenzime administrative	(25,317,540)	-	(25,317,540)
Zhvleresimi dhe amortizimi	(1,960,945)	-	(1,960,945)
Humbja nga mashtrimi	(116,398,580)	-	(116,398,580)
Fitim/(humbje) neto nga kembimi valutor	178,942	-	178,942
Totali i shpenzimeve operative	(193,896,459)	-	(193,896,459)
Fitimi/(Humbja) e vitit	(106,764,404)	-	(106,764,404)
Te ardhura te tjera gjithëpërshiresë	-	-	-
Totali i te ardhurave/(humbjes) gjithëpërshiresë per vitin	(106,764,404)	-	(106,764,404)

5 Administrimi i riskut financiar

Aktivitetet e Unifin SHKK janë nga natyra e tyre kryesisht të lidhur me instrumentet financiare. Një instrument financiar është një kontratë që krijon një të drejtë për të marrë mjete monetare ose një aktiv tjetër për njërën palë (aktiv financiar) ose detyrim për të dhënë mjete monetare ose një aktiv tjetër një pale tjetër (detyrim financiar). Instrumentet financiare rezultojnë në disa rreziqe për Unifin SHKK. Rreziqet më të rëndësishme me të cilat përballlet Unifin SHKK janë: risku i kredisë, risku i likuiditeti dhe risku i tregut.

Risku i tregut përfshin riskun e kurseve të këmbimit (riskun valutor), riskun e normës së interesit dhe rreziqe të tjera të çmimit.

Huamarrësit e Unifin SHKK mund të ndikohen negativisht nga ambjenti financiar dhe ekonomik, të cilët mund të ndikojnë në aftësinë e tyre për të shlyer shumat e borxhit. Përkeqësimi i kushteve ekonomike për huamarrësit mund të ketë një ndikim në rrjedhën e parashikimeve të manaxhimit për paratë të gatshme dhe vlerësimin e rënies së vlerës së mjeteve financiare dhe jo-financiare.

“UNIFIN” Shoqëri Kursim Krediti
31 Dhjetor 2019
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(Të gjitha shumat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

5 Administrimi i riskut financiar (vazhdim)

(i) Risku kreditor

Ekziston një rrezik kredie në momentin që palët nuk arrijnë të përmbushin detyrimet e tyre lidhur me pagesat e detyrimeve që kanë ndaj Unifin SHKK.

Unifin SHKK është subjekt i riskut kreditor nëpërmjet aktiveve të kredi-dhënies ndaj anëtarëve. Unifin SHKK manaxhon riskun kreditor duke lidhur marrëveshje vetëm me anëtarët dhe duke kryer një analizë të detajuar të riskut kreditor për çdo aplikim disbursimi dhe duke investuar likuiditetet e veta në banka tregtare vendase ose instrumente financiare të Qeverisë Shqiptare. Unifin SHKK monitoron rregullisht limitet dhe ekspozimet e veta kundrejt palëve individuale dhe anëtarëve.

Ekspozimi maksimal ndaj riskut kreditor përpara çdo provigjoni është paraqitur më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Mjetet monetare	331,033,996	203,542,258
Bono thesari	-	24,822,897
Kredi të dhëna anëtarëve	806,681,837	872,872,048
Aktive të tjera	49,348	31,248
	1,137,765,181	1,101,268,451

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Kredi të dhëna anëtarëve		
Standarde (0 - 30 Ditë)	795,467,260	874,790,071
Në ndjekje (31 - 90 Ditë)	17,810,946	13,112,790
Nënstandarte (91 - 180 Ditë)	13,079,224	3,446,999
Të dyshimta (181 - 365 Ditë)	16,548,338	9,637,434
Të humbura (Mbi 365 Ditë)	10,946,859	32,321,820
Kredite bruto	853,852,626	933,309,114
Minus zbritje provizioni	(47,170,789)	(60,437,066)
Kreditë neto	806,681,837	872,872,048

“UNIFIN” Shoqëri Kursim Krediti
31 Dhjetor 2019
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(Të gjitha shumat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

5 Administrimi i riskut financiar (vazhdim)

(ii) Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Unifin SHKK do të hasë vështirësi në grumbullimin e fondeve për të përmbushur angazhimet që lidhen me instrumentet financiare, dhe në përgjithësi për të ruajtur vazhdimësinë e veprimtarisë kryesore të bizneseve të tij (operacionet e kreditit, shërbimet depozituese dhe pagesave). Mbi një bazë operative, Unifin SHKK monitoron stabilitetin e depozitave të saj, dhe mbi këtë bazë rregullohen gjendjet e aktiveve afatshkurtra/ qasjen në fonde në mënyrë që të ruajë aftësinë e lartë paguese.

Tabela në vijim jep analizën e aktiveve dhe detyrimeve të Unifin SHKK me 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 sipas maturitetit të mbetur. Ajo merr në konsideratë fluksin e parave të paskontuara nga Shoqëria për aktivet dhe detyrimet financiare, sipas maturitetit kontraktual.

31 Dhjetor 2019	1 muaj	1 - 3 muaj	3 – 12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
Aktivi					
Mjete monetare	331,033,996	-	-	-	331,033,996
Bono thesari	-	-	-	-	-
Kredi dhënë anëtarëve (me vlerë bruto)	45,648,197	61,142,941	258,918,624	488,142,865	853,852,627
Aktive të tjera	49,348	-	-	-	49,348
Totali i aktiveve financiare	376,731,541	61,142,941	258,918,624	488,142,865	1,184,935,971
Detyrime					
Depozita nga anëtarët	192,005,480	170,380,893	530,974,215	127,125,266	1,020,485,854
Detyrime të tjera	3,569,474	-	-	-	3,569,474
Totali i detyrimeve financiare	195,574,954	170,380,893	530,974,215	127,125,266	1,024,055,328
Pozicioni neto	181,156,587	(109,237,952)	(272,055,591)	361,017,599	160,880,643

31 Dhjetor 2018	1 muaj	1 - 3 muaj	3 – 12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
Aktivi					
Mjete monetare	203,542,258	-	-	-	203,542,258
Bono thesari	-	-	24,822,897	-	24,822,897
Kredi dhënë anëtarëve (me vlerë bruto)	73,045,659	56,922,107	272,300,566	531,040,782	933,309,114
Aktive të tjera	31,248	-	-	-	31,248
Totali i aktiveve financiare	276,619,165	56,922,107	297,123,463	531,040,782	1,161,705,517
Detyrime					
Depozita nga anëtarët	203,481,805	116,725,864	550,691,030	120,540,534	991,439,233
Detyrime të tjera	4,737,333	-	-	-	4,737,333
Totali i detyrimeve financiare	208,219,138	116,725,864	550,691,030	120,540,534	996,176,566
Pozicioni neto	68,400,027	(59,803,757)	(253,567,567)	410,500,248	165,528,951

“UNIFIN” Shoqëri Kursim Krediti
31 Dhjetor 2019
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(Të gjitha shumat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

5. Administrimi i riskut financiar (vazhdim)

(iii) Risku i tregut

Risku i normës së interesit

Operacionet e Unifin SHKK janë subjekt i riskut të luhatjeve të normës së interesit në masën që aktivet dhe detyrimet që fitojnë/ mbartin interes maturohen apo interesi i tyre ricmohet në kohë apo në sasi të ndryshme. Unifin SHKK përpiqet të zvogëlojë këtë risk duke monitoruar datat e ricimit të aktiveve dhe detyrimeve të veta.

Përveç kësaj efekti aktual do të varet nga një numër faktorësh të tjerë, duke përfshirë edhe masën deri në të cilën pagesat janë bërë më herët apo më vonë sesa datat e kontraktuara dhe variacionet në ndjeshmërinë e normës së interesit brenda periudhave të ricimit dhe për cdo valutë.

31 Dhjetor 2019

	Deri 6 muaj	6 - 12 muaj	Mbi 1 vit	Nuk mbartin interes	Totali
Aktivi					
Mjete monetare	331,033,996		-	-	331,033,996
Bono thesari	-	-	-	-	-
Kredi dhënë anëtarëve (bruto)	182,810,986	182,898,776	488,142,865	-	853,852,627
Aktive të tjera	-	-	-	49,348	49,348
Totali i aktiveve fi- nanciare	513,844,982	182,898,776	488,142,865	49,348	1,184,935,971
Detyrime					
Depozita nga anëtarët	384,857,146	408,844,605	127,125,266	99,658,837	1,020,485,854
Detyrime të tjera	-	-	-	3,569,474	3,569,474
Totali i detyrimeve financiare	384,857,146	408,844,605	127,125,266	103,228,311	1,024,055,328
Pozicioni neto	128,987,836	(225,945,829)	361,017,599	(103,178,963)	160,880,643

31 Dhjetor 2018

	Deri 6 muaj	6 - 12 muaj	Mbi 1 vit	Nuk mbartin interes	Totali
Aktivi					
Mjete monetare	203,542,258	-	-	-	203,542,258
Bono thesari	24,822,897	-	-	-	24,822,897
Kredi dhënë anëtarëve (bruto)	216,721,589	185,546,743	531,040,782	-	933,309,114
Aktive të tjera	-	-	-	31,248	31,248
Totali i aktiveve fi- nanciare	445,086,744	185,546,743	531,040,782	31,248	1,161,705,517
Detyrime					
Depozita nga anëtarët	290,579,088	447,638,470	120,540,534	132,681,141	991,439,233
Detyrime të tjera	-	-	-	4,737,333	4,737,333
Totali i detyrimeve financiare	290,579,088	447,638,470	120,540,534	137,418,474	996,176,566
Pozicioni neto	154,507,656	(262,091,727)	410,500,248	(137,387,226)	165,528,951

“UNIFIN” Shoqëri Kursim Krediti
31 Dhjetor 2019
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(Të gjitha shumat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

5. Administrimi i riskut financiar (vazhdim)

(iv) Risku valutor

Unifin SHKK është i ekspozuar ndaj riskut të valutës nëpërmjet transaksioneve në monedhë të huaj. Risku valutor është risku që vlera e instrumentave financiare do të luhet për shkak të ndryshimeve në kurset e këmbimit.

Ekspozimet e transaksioneve të Unifin SHKK sjellin fitime dhe humbje nga valutat e huaja të cilat njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Këto ekspozime përbëhen nga aktive dhe detyrime monetare dhe Jo-monetare të Unifin SHKK të cilat nuk janë të mbajtura në monedhën funksionale.

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj riskut të kursit të këmbimit në 31 dhjetor 2019 dhe 2018 ishte si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019		
	LEK	EUR	USD
Mjetet monetare	287,980,611	38,340,292	4,713,093
Bono thesari	-	-	-
Kredi të dhëna anëtarëve	775,283,843	31,397,994	-
Aktive të tjera	49,348	-	-
Totali i aktiveve	1,063,313,802	69,738,286	4,713,093
Depozita nga anëtarët	947,123,724	67,502,305	5,859,825
Detyrime të tjera	3,569,474	-	-
Totali detyrimeve	950,693,198	67,502,305	5,859,825
Ekspozimi neto më 31 Dhjetor	112,620,604	2,235,981	(1,146,732)

	31 Dhjetor 2018		
	LEK	EUR	USD
Mjetet monetare	161,590,491	38,180,188	3,771,579
Bono thesari	24,822,897	-	-
Kredi të dhëna anëtarëve	845,997,835	26,874,213	-
Aktive të tjera	31,248	-	-
Totali i aktiveve	1,032,442,471	65,054,401	3,771,579
Depozita nga anëtarët	918,674,134	67,890,449	4,874,650
Detyrime të tjera	4,737,333	-	-
Totali detyrimeve	923,411,467	67,890,449	4,874,650
Ekspozimi neto më 31 Dhjetor	109,031,004	(2,836,048)	(1,103,071)

Kursi i këmbimit të Lek-ut në përfundim të periudhës raportuese ishte si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
1 USD	108.64	107.82
1 EUR	121.77	123.42

Forcimi ose dobësimi i monedhës Lek me 10% kundrejt monedhës EUR më 31 dhjetor 2019 do të sillte rritje ose ulje në kapital dhe rezultat në shumën 223,598 Lek (31 Dhjetor 2018: 283,605).

Forcimi ose dobësimi i monedhës Lek me 10% kundrejt monedhës USD më 31 dhjetor 2019 do të sillte rritje ose ulje në kapital dhe rezultat në shumën 114,673 Lek (31 Dhjetor 2018: 110,307 Lek).

“UNIFIN” Shoqëri Kursim Krediti**31 Dhjetor 2019****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare***(Të gjitha shumat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)***5. Administrimi i riskut financiar (vazhdim)****(v) Menaxhimi i kapitalit**

Rregullorja për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e shoqërive të kursim kreditit kërkon një shumë minimale të kapitalit për të mbuluar ekspozimin ndaj rrezikut dhe atij të tregut. Tabela e mëposhtme paraqet kërkesat e rregullores si dhe përqindjet e Unifin SHKK në datën e bilancit.

	31 Dhjetor 2019
Totali i zërave të ponderuara me rrezikun	883,708,840
Totali i zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezikun	-
Totali i aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezikun	883,708,840
Kapitali i SHKK-se	127,950,941
Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (4/3)*100	
Në dy vitet e para të veprimtarisë	jo më pak se 10% 14.48
Në vitet në vazhdim	jo më pak se 12% 14.48
Kapitali / Totali i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara neto	jo më pak se 100% 879.55
Kapitali / Totali i kredive me probleme (neto) të pa garantuara me cash	jo më pak se 100% 1,067.63

6 Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 janë përbërë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Mjete monetare në arkë	696,057	2,753,621
Llogari rrjedhëse në banka	228,769,855	119,458,807
Depozita në banka vendase	101,568,084	81,329,830
Totali	331,033,996	203,542,258

Depozitat në mjetet monetare përfshijnë depozita me afat të mbetur maturimi me të vogël se tre muaj nga data e raportimit.

Shoqëria ka nënshkruar një kontratë overdrafti me limit 23,000,000 Leke me 18 Shtator 2019. Me 31 Dhjetor 2019 balanca e përdorur e overdraftit ishte 0.

“UNIFIN” Shoqëri Kursim Krediti
31 Dhjetor 2019
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(Të gjitha shumat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

7 Bono thesari

Bonot e thesarit më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 janë përbërë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Bono thesari	-	24,822,897
Totali	-	24,822,897

8 Kredi të dhëna anëtarëve

Kreditë përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Kredi të dhëna anëtarëve (bruto)	853,852,627	933,309,114
Fond provizionit	(47,170,790)	(60,437,066)
	806,681,837	872,872,048

Kreditë e dhëna anëtarëve në Lekë mbartin interesa nga 4.5% deri në 15% dhe kanë maturitet deri në 5 vite. Kreditë në Euro mbartin interes nga 10% deri në 13% dhe kanë maturitet deri në 7 vite.

Unifin ka aplikuar përqindjet minimale në vijim për secilën kategori risku të përcaktuar në rregulloren e mbikqyrjes, në lidhje me kreditë e dhëna ndaj anëtarëve.

	Normat e provizionimit
Standarde (0 - 30 Ditë)	2%
Në ndjekje (31 - 90 Ditë)	15%
Nënstandarde (91 - 180 Ditë)	40%
Të dyshimta (181 - 365 Ditë)	75%
Të humbura (Mbi 365 Ditë)	100%

Lëvizja në fondin e provizionit për huatë dhënë anëtarëve paraqitet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Më 1 Janar	(60,437,066)	(50,677,891)
Kreditë e fshira	57,972,585	-
Fondi i provizionit për vitin	(44,706,309)	(9,759,175)
Më 31 Dhjetor	(47,170,790)	(60,437,066)

“UNIFIN” Shoqëri Kursim Krediti
31 Dhjetor 2019
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(Të gjitha shumat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

9 Aktive afatgjata materiale

Aktivët afatgjata materiale më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 janë përberë si më poshtë:

	Mjete transporti	Inventare ekonomike	Totali
Kosto			
Gjendja më 1 Janar 2018	1,105,849	14,123,076	15,228,924
Shtesa	-	2,689,378	2,689,378
Nxjerrje jashtë përdorimi	-	(146,360)	(146,360)
Gjendja më 31 Dhjetor 2018	1,105,849	16,666,094	17,771,942
Shtesa	-	258,147	258,147
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	(57,923)	(57,923)
Gjendja më 31 Dhjetor 2019	1,105,849	16,866,318	17,972,166
Zhvlerësimi i akumuluar			
Gjendja më 1 Janar 2018	110,575	1,025,707	1,136,282
Zhvlerësimi i vitit	110,595	1,685,470	1,796,065
Nxjerrje jashtë përdorimi	-	(146,361)	(146,361)
Gjendja më 31 Dhjetor 2018	221,170	2,564,816	2,785,986
Zhvlerësimi i vitit	110,585	1,761,068	1,871,653
Nxjerrje jashtë përdorimi	-	(57,923)	(57,923)
Gjendja më 31 Dhjetor 2019	331,755	4,267,961	4,599,716
Vlera kontabël neto			
Më 31 Dhjetor 2018	884,679	14,101,278	14,985,956
Më 31 Dhjetor 2019	774,094	12,598,357	13,372,450

“UNIFIN” Shoqëri Kursim Krediti
31 Dhjetor 2019
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(Të gjitha shumat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

10 Aktive afatgjata jo materiale

Aktivët afatgjata jo materiale më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 janë përberë si më poshtë:

	Programe	Totali
Kosto		
Gjendja më 1 Janar 2018	1,655,993	1,655,993
Shtesa	-	-
Nxjerrje jashtë përdorimi	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2018	1,655,993	1,655,993
Shtesa	51,000	51,000
Nxjerrje jashtë përdorimi	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2019	1,706,993	1,706,993
Amortizimi i akumuluar		
Gjendja më 1 Janar 2018	165,599	165,599
Amortizimi i vitit	164,880	164,880
Nxjerrje jashtë përdorimi	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2018	330,479	330,479
Amortizimi i vitit	167,326	167,326
Nxjerrje jashtë përdorimi	34,287	34,287
Gjendja më 31 Dhjetor 2019	532,092	532,092
Vlera kontabël neto		
Më 31 dhjetor 2018	1,325,514	1,325,514
Më 31 dhjetor 2019	1,174,901	1,174,901

11 Të tjera të arkëtueshme

Aktive të tjera më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Interesa te perllogaritura te depozitave	29,348	25,248
Parapagime	1,148,783	1,434,073
Debitore te tjere	20,000	6,000
	1,198,131	1,465,321

“UNIFIN” Shoqëri Kursim Krediti
31 Dhjetor 2019
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(Të gjitha shumat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

12 Depozita nga anëtarët

Depozitat nga anëtarët më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Depozita pa afat	60,614,045	64,837,112
Depozita me afat	846,100,179	784,356,049
Depozita të bllokuara	88,147,000	121,386,368
Interesa të perllogaritura	25,624,630	20,859,704
	1,020,485,854	991,439,233

13 Detyrime të tjera

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Fonde rezerve	1,455,046	12,706,257
Detyrime tatimore	1,851,946	2,553,690
Detyrime të tjera	724,086	843,309
Detyrime ndaj furnitoreve	993,442	1,340,334
Detyrime ndaj punonjësve	-	100,060
	5,024,520	17,543,650

14 Kontribute të anetaresimit dhe donacione

Kapitali i Unifin SHKK përbëhet si vijon:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Kontribute të anetaresimit	18,518,846	15,657,796
Fondet të dhuruara të donatoreve	66,803,819	66,803,819
	85,322,665	82,461,615

15 Të ardhura nga interesat

Të ardhurat nga interesat të Unifin SHKK analizohen si më poshtë.

	31 Dhjetor 2019	31 Djetor 2018
Të ardhura nga interesi i kredive	117,624,045	119,190,914
Të ardhura nga interesi i depozitave dhe bonove	663,691	1,715,413
Të ardhura nga interesi i llogarive rrjedhëse	1,816	34,398
	118,289,552	120,940,725

16 Shpenzime interesi

Shpenzimet e interesit përbëhen nga interesat e krijuara nga depozitat me afat të vendosura nga anëtarët. Depozitat me afat mbajnë interesa nga 0.5% deri në 6.2%.

“UNIFIN” Shoqëri Kursim Krediti
31 Dhjetor 2019
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(Të gjitha shumat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

17 Te ardhura te tjera

	31 Dhjetor 2019	31 Djetor 2018
Te ardhura nga shitja e kredive	27,489,834	-
Te ardhura nga komisionet e disbursimit	3,315,823	-
Te ardhura te tjera	187,084	1,878,324
Totali	30,992,741	1,878,324

18 Shpenzime personeli

Kostoja e punës përbëhet nga pagat dhe kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të cilat analizohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Djetor 2018
Pagat bruto	36,266,990	40,971,069
Kontributet e sigurimeve shoqërore	4,878,856	4,783,053
Kontributet e sigurimeve shëndetësore	617,469	694,015
Honorare	3,423,615	3,950,199
	45,186,930	50,398,336

Numri i te punësuarve ne dhjetor 2019 ishte 41 (2019: 44). Numri mesatar i tepunësuarve ne Shoqëri gjate vitit 2019 ishte 40.

19 Shpenzime administrative

Shpenzimet administrative analizohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Djetor 2018
Qira	6,725,965	6,494,206
Shpenzime zyre	3,345,152	4,512,685
Shpenzime per sigurimin e depozitave	2,291,382	1,938,641
Shpenzime te tjera administrative	1,752,617	1,732,831
Komunikim	1,532,240	1,399,563
Transport, dieta etj	1,499,542	1,337,461
Shpenzime konsulence	1,027,718	1,286,450
Taksa dhe tarifa vendore	907,245	1,161,723
Energji, Uje etj	1,072,781	1,038,502
Trajnime	48,471	1,012,311
Shpenzime per sigurimin e jetes se debitorit	-	924,727
Publicitet, reklama	375,315	722,772
Shpenzime per bordin drejtues	502,561	760,174
Shpenzime gjyqesore	467,500	-
Shpenzime per pritje eperfaqesime	256,695	539,066
Sherbime bankare	281,980	456,428
	22,087,164	25,317,540

“UNIFIN” Shoqëri Kursim Krediti
31 Dhjetor 2019
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(Të gjitha shumat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

20 Analize maturimi per aktivet dhe detyrimet

31 Dhjetor 2019	< 12 muaj	> 12 muaj	Totali
Aktivët			
Mjetet monetare dhe ekuivalente me to	331,033,996	-	331,033,996
Bono thesari	-	-	-
Kredi te dhena anetareve	338,130,610	468,551,227	806,681,837
Aktive afatgjata material	-	13,372,450	13,372,450
Aktive afatgjata jomateriale	-	1,174,901	1,174,901
Aktive të tjera	1,198,131	-	1,198,131
Totali	670,362,737	483,098,578	1,153,461,315
Detyrimet			
Depozita nga anetaret	893,360,588	127,125,266	1,020,485,854
Detyrime te tjera	3,569,474	1,455,046	5,024,520
Totali	896,930,062	128,580,312	1,025,510,374
Neto	(226,567,325)	354,518,266	127,950,941
31 Dhjetor 2018	< 12 muaj	> 12 muaj	Totali
Aktivët			
Mjetet monetare dhe ekuivalente me to	203,542,258	-	203,542,258
Bono thesari	24,822,897	-	24,822,897
Kredi te dhena anetareve	357,870,054	515,001,994	872,872,048
Aktive afatgjata material	-	14,985,956	14,985,956
Aktive afatgjata jomateriale	-	1,325,514	1,325,514
Aktive të tjera	1,465,321	-	1,465,321
Totali	587,700,530	531,313,464	1,119,013,994
Detyrimet			
Depozita nga anetaret	870,898,699	120,540,534	991,439,233
Detyrime te tjera	4,837,393	12,706,257	17,543,650
Totali	875,736,092	133,246,791	1,008,982,883
Neto	(288,035,562)	398,066,673	110,031,111

21 Humbja nga mashtrimi

Ne fillim te muajit mars 2019 kontrolli i brendshem konstatoi shkelje nga administratori i zyres Vlore, per te cilat u morren menjehere masa per heqje autorizemeve te punonjeve pergjegjes. Masat e menjehereshme u bene shkas qe punonjesja e deges ne pozicionin e Adminsitraores se Deges, te bente vetedeklarimin e te gjithë skemes se mashtrimit. Mashtrimi perfshinte krijimin e kredive e kredive fiktive duke pervetesuar shumat e disbursuara dhe terheqje te pa-autorizuara te depozitave dhe llogarive rrjedhese nepermjet falsifikimit te firmave.

Nga vetedeklarimet e punonjeses dhe verifikimet e metejshe me te kryera nga Shoqeria rezultoi se humbja nga mashtrimi ne total ishte ishte 120,900,241 Leke (31 Dhjetor 2018 ishte 116,398,580).

Llogaria e kredive per anetaret eshte pakesuar per shumen e kredive fiktive ne fund te vitit 2018 duke pakesuar fitimin e vitit. Gjithashtu eshte bere vleresimi sa jane balancat e depozitave ne fund te vitit pas rregullimeve te shumave te pervetesuara dhe efekti i humbjes eshte perfshire ne rezultatin e vitit.

“UNIFIN” Shoqëri Kursim Krediti**31 Dhjetor 2019****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare***(Të gjitha shumat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)***22 Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara**

Përgjatë rrjedhës normale të aktivitetit të tij, Unifin SHKK përballet me padi të ndryshme ligjore. Drejtimi i Unifin SHKK është i mendimit se nuk do të ketë humbje të rëndësishme nga paditë ligjore në proces më 31 dhjetor 2018. Me 31 Dhjetor 2019 Shoqëria nuk ka padi ligjore në proces.

23 Palët e lidhura

Një përmbledhje e balancave dhe transaksioneve me palët e lidhura është si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Aktive		
Kredi dhënë anëtarëve	806,681,837	872,872,048
Detyrime		
Depozita nga anëtarët	1,020,485,854	991,439,233
Të ardhura gjatë periudhës		
Të ardhura interesi	118,289,552	120,940,725
Shpenzime të periudhës		
Shpenzime interesi	(33,746,141)	(29,984,380)

24 Ngjarje pas datës së raportimit

Në fund të vitit 2019 dolën për herë të parë lajmet nga Kina në lidhje me COVID-19 (Coronavirus).

Stuata në fund të vitit ishte që një numër i kufizuar rastesh nga virusi i panjohur ishin raportuar në Organizatën Botërore të Shëndetësisë. Në muajt e parë të vitit 2020 virusi ishte shpërndarë globalisht dhe ndikimi negativ ishte i dukshëm. Manaxhimi konsideron që kjo ngjarje të jetë një ngjarje jo-axhustuese pas datës së bilancit. Ndërsa kjo është ende një situatë në zhvillim gjatë kohës së përgatitjes së këtyre pasqyrave financiare, manaxhimi beson se nuk do të ketë ndikim thelbësor në vazhdimësinë e operimit të Shoqërisë. Menaxhimi do vazhdojë të monitorojë ndikimin e mundshëm dhe do ndërmarrë gjithë hapat e mundshëm për të zbutur cfarëdo efekesh.

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së raportimit që do të kërkonte rregullime apo shpjegime të mëtejshme për pasqyrat financiare të Unifin SHKK.